

**ALMARK Sh.p.k.**

**Pasqyrat Financiare  
më 31 dhjetor 2015  
dhe për periudhën nga  
1 prill 2015 (data e krijimit)  
deri më 31 dhjetor 2015**

## OPINIONI I AUDITUESIT TË PAVARUR

### Drejtuar aksionarit të Almark sh.p.k

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkangjitur të Almark sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015, dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin ushtrimor të mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

### Përgjegjësia e Drejtimit për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe për ato kontrolle të brendshme, të cilat drejtimi i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa pasaktësi materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimeve.

### Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare janë pa pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumatat dhe deklarimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të shoqërisë në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të kontabilitetit të përdorura dhe pranueshmërinë e vlerësimeve kontabël të kryera nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

### Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të pozicionit financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2015, si dhe të performancës financiare dhe të flukseve monetare të saj për vitin ushtrimor të mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Raportimit Financiar.

Ernst & Young - Ekspert Kontabël i Autorizuar  
Dega në Shqipëri

18 korrik 2016  
Tiranë, Shqipëri

*Ernst & Young Certified Auditors*



Mario Vangjel  
Ekspert Kontabël i Regjistruar

*Mario Vangjel*

<b>RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR .....</b>	<b>.....</b>
<b>PASQYRA PERMBLEDHESE E TE ARDHURAVE.....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....</b>	<b>2</b>
<b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL.....</b>	<b>1</b>
<b>Për periudhën nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015.....</b>	<b>1</b>
<b>1. Informacione te pergjitheshme .....</b>	<b>2</b>
<b>2. Bazat e përgatitjes.....</b>	<b>2</b>
<b>3. Politika të rëndësishme kontabël.....</b>	<b>4</b>
<b>4. Standarde dhe interpretime të publikuara që kanë hyrë në fuqi .....</b>	<b>10</b>
<b>5. Standarte te emetuara por qe ende nuk kane hyre ne fuqi dhe nuk jane adoptuar ende.....</b>	<b>11</b>
<b>6. Te ardhurat .....</b>	<b>13</b>
<b>7. Te ardhura te tjera operative.....</b>	<b>13</b>
<b>8. Kosto e mallrave te shitura .....</b>	<b>13</b>
<b>9. Shpenzime materialesh.....</b>	<b>14</b>
<b>10. Shpenzime per sherbime .....</b>	<b>14</b>
<b>11. Perfitime te punonjesve.....</b>	<b>14</b>
<b>12. Fitime/(humbje) neto nga kurset e kembimit.....</b>	<b>14</b>
<b>13. Shpenzime te tjera .....</b>	<b>15</b>
<b>14. Shpenzime financiare neto .....</b>	<b>15</b>
<b>15. Tatimi mbi fitimin.....</b>	<b>16</b>
<b>16. Aktivët afatgjata materiale.....</b>	<b>17</b>
<b>17. Aktive afatgjata jomateriale .....</b>	<b>18</b>
<b>18. Inventari .....</b>	<b>18</b>
<b>19. Llogari te arketueshme dhe te drejta te tjera.....</b>	<b>18</b>
<b>20. Mjete monetare dhe ekuivalentet e saj.....</b>	<b>19</b>
<b>21. Kapitali aksionar.....</b>	<b>19</b>
<b>22. Huate.....</b>	<b>19</b>
<b>23. Llogari te pagueshme dhe detyrime te tjera .....</b>	<b>20</b>
<b>24. Palet e lidhura .....</b>	<b>20</b>
<b>25. Angazhime dhe detyrime te kushtezuara.....</b>	<b>21</b>
<b>26. Objektivat dhe politikat e menaxhimit te riskut financiar.....</b>	<b>22</b>
<b>27. Ngjarje pas dates se raportimit.....</b>	<b>23</b>

**ALMARK SH.P.K.***(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA PERMBLEDHESE E TE ARDHURAVE**

Për periudhën nga 1 Prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015

	Shënime	<u>Periudha nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015</u>
Shitjet	6	2,048,687
Te ardhura te tjera operative	7	96,018
<b>Te ardhura operative bruto</b>		<b>2,144,705</b>
Kosto e shitjeve	8	(1,795,994)
Shpenzime per materiale	9	(11,594)
Shpenzime per sherbime	10	(484,626)
Pagat	11	(124,486)
Shpenzime te tjera	13	(86,403)
Amortizimi dhe zhvleresimi	16,17	(14,299)
Fitimi neto i kembimeve valutore	12	6,674
<b>Shpenzime operative</b>		<b>(2,510,729)</b>
Shpenzime financiare	14	(10,832)
<b>Humbja para tatimit</b>		<b>(376,857)</b>
Tatim fitimi	15	-
Aktive tatimore te shtyra		1,377
<b>Totali i humbjeve permbledhese per vitin</b>		<b>(375,480)</b>

Shenimet shoqeruese mbi pasqyrat financiare nga 1 ne 27 jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare.

**ALMARK SH.P.K.***(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR  
Me 31 dhjetor 2015**

	Shënime	<u>31 dhjetor 2015</u>
<b>Aktive</b>		
<b>Aktive afatgjata</b>		
Aktive afatgjata materiale	16	224,123
Aktive jo-materiale	17	5,078
		<u>229,201</u>
<b>Aktive afatshkurtra</b>		
Inventar	18	609,024
Kerkesa per arketim nga debitorët	19	515,546
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	20	122,465
Aktive tatimore te shtyra		1,377
		<u>1,248,412</u>
		<u>1,477,613</u>
<b>Totali i Aktiveve</b>		
<b>Kapitali dhe Detyrimet</b>		
<b>Kapitali dhe rezervat e zoteruesve te kapitalit te kompanise</b>		
Aksione te zakonshme	21	79,786
Humbja e mbartur		-
Humbja per vitin		(375,480)
<b>Totali i kapitaleve te veta</b>		<u>(295,693)</u>
<b>Detyrime</b>		
<b>Detyrime afatgjata</b>		
Huamarrje afatgjata	22	513,136
		<u>513,136</u>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>		
Huamarrje afatshkurtra	22	324,170
Llogari te pagueshme dhe detyrime te tjera	23	936,000
		<u>1,260,170</u>
		<u>1,773,307</u>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<u>1,477,613</u>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitaleve te veta</b>		

Keto pasqyra financiare, dhe shenimet shpjeguese nga 1 deri ne 27, te cila jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare, jane autorizuar nga drejtimi me 28 shkurt 2016 dhe nenshkruar ne emer te tij nga:

Elona Mema  
Administratore




**ALMARK SH.P.K.**

(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL**

Për periudhën nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015

	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>Humbja e mbartur</b>	<b>Totali i kapitalit</b>
<b>Gjendja më 1 prill 2015 (data e krijimit)</b>	<u>79,786</u>	<u>-</u>	<u>79,786</u>
Humbja e vitit	<u>(375,480)</u>	<u>-</u>	<u>(375,480)</u>
<b>Humbja totale gjithëpërshiresë për vitin me 31 dhjetor 2015</b>	<u><b>(295,694)</b></u>	<u><b>-</b></u>	<u><b>(295,694)</b></u>

Shenimet shoqeruese mbi pasqyrat financiare nga I ne 27 jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare.

**ALMARK SH.P.K.***(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE****Për periudhën nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015**

Shenime	Periudha nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015
<b><i>Veprimtarite operative</i></b>	<b>(376,857)</b>
Humbja perpara tatimit prej aktivitetit te pandërprere	<u>(376,857)</u>
<b>Humbja para tatimit</b>	<b>16,17 14,299</b>
Amortizimin dhe zhvleresimi	-
Renie ne inventar	73,140
Provigjoni	14 10,832
Shpenzime interesi, neto	
<b>Rregullime ne kapitalin qarkullues:</b>	<b>(596,343)</b>
Rritja i llogarive te arketueshme, bruto	(609,024)
Rritja i inventareve	936,000
Rritja e llogarive te pagueshme	<u>(10,832)</u>
Interesi i paguar	<u>(573,260)</u>
<b>Flukset monetare te perdorura ne/nga veprimtarite operative</b>	
<b><i>Veprimtarite investuese</i></b>	
Blerja a aktiveve afatgjata materiale	16, 17 (243,501)
Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	7,657
<b>Flukset neto monetare te perdorura ne veprimtarite operative</b>	<b><u>(235,844)</u></b>
<b><i>Veprimtarite financuese</i></b>	
Rritje e kapitalit te regjistruar	79,786
Te hyra nga huamarrjevet	22 837,307
<b>Flukset monetare nga/ te perdorura ne veprimtarite financuese</b>	<b><u>917,093</u></b>
<b>Pakesimi neto i mjeteve monetare dhe ekuivalenteve me to</b>	<b>122,465</b>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim te vitit	-
<b>Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund te vitit</b>	<b>20 122,465</b>

Shenimet shoqeruese mbi pasqyrat financiare nga 1 ne 27 jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare.

## **ALMARK SH.P.K.**

### **Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015**

---

*(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)*

#### **1. Informacione te pergjitheshme**

Shoqëria Almark sh.p.k. është krijuar me datë 01 prill 2015 dhe është regjistruar në regjistrin e shoqërive tregtare në të njëjtën ditë, me kapital të nënshkruar 100 Lekë. Pas disa zmadhimesh kapitali, aktualisht kapitali i shoqërisë është 79,786,400 Lekë. Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortaku i vetem Balfin shpk, zotërues i 100% të kuotave.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është: tregtimi i mallrave me shumicë e pakicë, Import-Eksport, etj, sipas objektit të veprimtarisë të përcaktuar në Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Administrator i shoqërisë është Znj. Elona Mema. Numeri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2015 është 446 persona.

#### **2. Bazat e përgatitjes**

##### **2.2 Monedha e paraqitjes**

Keto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekun Shqiptar ("LEK"), e cila është edhe monedha funksionale e Shoqërisë, të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe.

##### **2.3 Deklarata e perputhshmerise**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Nderkombetare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe mbi supozimin biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh që Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

##### **2.4 Baza e matjes**

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë përgatitur bazuar në koston historike, me përjashtim të rivlerësimit të tokës dhe ndërtesës me vlerën e drejte, të cilat maten me vlerën e drejte, parimit të drejtave dhe detyrimeve të shtyra, konceptit të kujdesit dhe janë të matura mbi bazën e parimit të vijimësisë.

##### **2.5 Perdorimi i vleresimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga keto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabel njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme në ato ndikohen.

Në veçanti, elemente të rëndësishme në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabel që kanë efekt material në vlerat kontabel në pasqyrat financiare janë të përshkruara në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.



*(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)*

## **2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)**

### **2.5 Perdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)**

#### *Tatimi mbi fitimin*

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatim fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar i tatimit është i pasigurtë. Shoqëria njih detyrimet për çështjet e parashikuara tatimore të auditimit bazuar në vlerësimin nëse do të ketë shtesa në taksë. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat kanë qenë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në tatim fitimin aktual dhe të shtyrë dhe detyrimet në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë. Shoqëria përcakton dispozitat, në bazë të vlerësimeve të arsyeshme, për pasojat e mundshme të kontroleve nga autoritetet tatimore të vendit në të cilën vepron. Shuma e dispozitave të tilla është e bazuar në faktorë të ndryshëm, si përvoja e auditimeve të mëparshme tatimore dhe interpretimeve e rregullave tatimore të ndryshme nga njësite ekonomike të tatueshme dhe autoriteti përgjegjës tatimore.

Dallimet e tilla të interpretimit mund të krijojnë një shumëllojshmëri të gjerë çështjesh në varësi të kushteve që mbizotërojnë në vendbanimin e kompanisë përkatëse. Shoqëria vlerëson mundësinë për një çështje gjyqësore dhe daljeve të mëvonshëm të paravë , lidhur me tatimet të largëta dhe kur nuk ka detyrim kontingjent që kane qenë te njohur.

Asetet e tatimit të shtyrë njihen për të gjitha humbjet tatimore të papërdorura deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit humbjet mund të shfrytëzohen. Gjykimi i rëndësishëm i menaxhimi është e nevojshme për të përcaktuar shumën e aktiveve të shtyra tatimore që mund të njihen, të bazuar mbi mundësinë e kohës dhe nivelin e fitimit të tatueshëm të ardhshëm së bashku me strategjitë e ardhshme të planifikimit tatimor.

#### *Përcaktimi i vlerës së drejtë*

Nuk ka politika të rëndësishme kontabël të adoptura nga Shoqëria të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime të informacioneve shpjeguese të bazuara në metodat e mëposhtme. Kur janë të aplikueshme, informacione rreth supozimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë paraqiten në shënimet specifike të aktiveve ose detyrimeve.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përfshihet në vlerën në të cilën instrumenti mund të

të shkëmbehentë një transaksion rrjedhës mes palëve të vullnetëshme , të ndryshëm nga një shitje të detyruar ose të likuiduar.

Metodat dhe supozimet e mëposhtme janë përdorur për vlerësimin e vlerave të drejta:

- Normë afatgjatë fikse dhe variabël të arkëtueshmet/huamarrjet janë vlerësuar nga Shoqëria në bazë të parametrave të tilla si normat e interesit, faktorëve të veçantë rrezikut të vendit, besueshmëria kreditore individuale e klientit dhe karakteristikat e rrezikut të projektit të financuar. Bazuar në këtë vlerësim, shtesat janë marrë parasysh për humbjet e pritshme të këtyre arkëtueshmeve. Më 31 dhjetor 2015 vlera kontabël e llogarive të arkëtueshme të tilla, neto të shtesave, nuk ishin materialisht të ndryshme nga vlerat e tyre të drejta të llogaritura.
- Vlera e drejtë e shënimeve të kuotuarra dhe të obligacioneve është i bazuar në kuotimin e çmimeve, në datën e raportimit. Vlera e drejtë e instrumentave të pakuotuarra, kredi nga bankat dhe detyrimeve të tjera financiare, detyrimet sipas qirasë financiare, si dhe detyrimet e tjera afatgjata financiare vlerësohet duke skontuar flukset monetare të ardhshme duke përdorur normat aktualisht në dispozicion për borxhin në kushte të ngjashme, rreziku i kreditimit dhe maturitetet të mbetur.

*(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)*

### **3. Politika të rëndësishme kontabël**

Politikat e rëndësishme kontabel te perdorura nga Shoqëria ne perгатitjen e pasqyrave financiare jane ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar ("SNRF").

#### **(a) Transaksionet në monedhë të huaj**

Regjistrimet kontabël të njësisë janë të përgatitura në Lekë Shqiptar, e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilën operon shoqëria.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale (monedha të huaja) rregjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës së raportimit. Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë që janë të regjistruara në monedhë të huaj, rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

Diferencat nga këmbimi njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse si fitim apo humbje në periudhën në të cilën ata ndodhin përveç diferencave të këmbimeve për huamarrjet në monedhë të huaj të lidhura me aktivet në ndërtim për përdorim të ardhshëm, të cilat përfshihen në kostot e atyre aktiveve kur ato lidhen me një rregullim në koston e interes të huamarrjeve në monedhë të huaj.

#### **(b) Instrumentat financiare**

Shoqëria fillimisht i ka njohur llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në datën e krijimit të tyre. Të gjitha aktivet e tjera financiare (duke përfshirë edhe aktivet e vlerësuar me vlerën e drejtë) njihen në datën e tregtimit, datën kur shoqëria ka lidhur një kontratë për këto instrumenta. Shoqëria ç'regjistron një aktiv financiar në momentin kur të drejtat kontraktuale për flukset nga këto aktive skadojnë, ose transferon të gjitha të drejtat për të përfituar flukset kontraktuale të të ardhurave të aktivit financiar me anë të një transaksioni, i cili transferon përfitimet dhe rreziqet që lidhen me pronësinë e aktivit. Ndonjë interes që është mbajtur apo krijuar mbi aktivet e transferuara nga shoqëria paraqitet më vete si një e drejtë apo detyrim. Detyrimet dhe të drejtat financiare kompesohen dhe paraqiten me vlerën neto në bilanc, vetëm kur shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar vlerat dhe ka për qëllim të shlyejë këto në vlerë neto, apo të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Instrumentat financiar jo derivativë të shoqërisë përfshijnë të drejta të tregtueshme dhe të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, detyrime të tregtueshme dhe të tjera.

*Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj*

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijn para në arkë dhe llogaritë rrjedhëse bankare.

*Llogaritë e arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit minus humbjet nga zhvlerësimi.

*Llogaritë e pagueshme*

Llogaritë e pagueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

*Të tjera*

Instrumenta të tjera financiare jo derivativë janë matur me koston e amortizueshme, duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimet.

*Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si kapital.

*(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)*

### **3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **(b) Instrumentat financiare (vazhdim)**

##### **Aktivitet afatgjata te Investuara**

Aktive afatgjata te investuara, të cilat janë prona të mbajtura për të fituar të ardhura nga qerata dhe / ose për rivlerësimin e kapitalit (duke përfshirë prona në ndërtim për qëllime të tilla), maten fillimisht me kosto, duke përfshirë koston e transaksionit. Ato njihen fillimisht në pasqyrën e pozicionit financiar në momentin që rreziqet dhe përfitimet nga pronësia transferohen te Shoqëria pavarësisht nga fakti nëse titulli është transferuar apo jo. Ato maten fillimisht me kosto. Pas momentit të njohjes, në vijim aktivitet afatgjata investimi maten me modelin e koston.

Aktivitet afatgjata investimi, të cilat janë në proces ndërtimi të lidhura me projekte të reja me të cilat po merrët Shoqëria, për ndërtimin e magazinave që do të jepen me qera ku përfshirja e Shoqërisë në menaxhimin do të jetë minimale. Si e tillë, Shoqëria po llogarit kostot direkte të ndodhura gjatë procesit të ndërtimit dhe sjelljes së aktivitet në kushtet për t'u dhënë me qera.

#### **(c) Aktive afatgjata materiale**

##### *Njohja dhe matja*

Aktivitet afatgjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe kosto të tjera që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë për sjelljen e aktivitet në gjëndje pune për qëllimin që i është caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjes së aktiveve dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjëndjen e mëparshme, si dhe kostot e kapitalizuara të huave. Kostot gjithashtu mund të përfshijnë zëra të transferuar nga të ardhurat të tjera përmbledhëse për fitime apo humbje të kualifikimit të flukseve të parasë të mbuluara nga blerjet në monëdhë të huaj të aktiveve afatgjata materiale. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisjeje.

Në momentin që një nga aktivitet afatgjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato rregjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale percaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivitet afatgjatë material dhe njihen neto në të ardhura ose humbje të tjera.

##### *Kostot në vijim*

Kostot për zëvendësimin e një pjese të aktivitet afatgjatë material rregjistrohen me vlerën kontabël të aktivitet në rast së është e mundur që përfitimet ekonomike në periudhat e ardhshme të përfshira në të të mund të rrjedhin tek Shoqëria dhe kostoja të mund të matet me besueshmëri. Vlera e kontabël e pjesëve të ndërruara si rrjedhojë ç'rregjistrohet. Kostoja e shërbimit ditor, të vazhdueshëm të ndërtesave dhe paisjeve rregjistrohet tek fitimet ose humbjet kur ato ndodhin.

*(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)****(c) Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***Amortizimi*

Amortizimi llogaritet mbi një bazë lineare mbi jetegjatesinë e vlerësuar të aktiveve. Për aktivet materiale në progres nuk llogaritet amortizim, deri në momentin kur aktivet janë të vlefshme për përdorim. Toka nuk amortizohet. Normat vjetore të amortizimit për klasat kryesore të aktiveve afatgjata materiale janë si më poshtë:

<b>Pershkrimi</b>	<b>Norma vjetore e amortizimit</b>
Ndërtesa	5%
Makineri e Pajisje	5%
Mjete transporti	20%
Pajisje informatike	25%

Një ze i aktiveve afatgjata materiale c'regjistrohet kur nxirret jashtë përdorimi apo shitet ose kur nuk priten përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi ose shitja. Cdo fitim ose humbje që rrjedh nga mosnjohja (c'regjistrimi) e aktivitetit (llogaritur si diferencë mes të ardhurave nga pakesimi dhe vlerës kontabël të aktivitetit), paraqitet në të ardhura ose shpenzime kur aktiviteti c'regjistrohet.

Vlera e mbetur e aktivitetit, jeta e dobishme dhe metodat e amortizimit rishikohen çdo periudhë financiare, duke bërë ndryshimet e nevojshme sipas rastit në fund të çdo viti financiar.

**(d) Aktive afatgjata jomateriale***Njohja dhe matja*

Aktivitet afatgjata jomateriale të përfuara vecmas njihen fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare, aktivitet afatgjata jomateriale njihen me koston minus amortizimin e akumuluar, dhe zhvlerësimin e akumuluar, nëse ka.

*Kostot në vijim*

Kostot në vijim kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktiviteti specifik me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë shpenzimet e gjenerimit të emrit të mirë dhe markës, njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në humbje ose fitime) në momentin e ndodhjes.

*Amortizimi*

Aktivitet afatgjata jomateriale me jete të dobishme të përcaktuar amortizohen përgjate jetes se tyre të dobishme ekonomike dhe vlerësohen për zhvlerësim sa here që ka një tregues që aktivitet afatgjatë jomaterial mund të jete zhvlerësuar. Periudha dhe metoda e amortizimit të aktiveve afatgjata jomateriale me jete të dobishme të përcaktuar, rishikohet të pakten në çdo datë raportimi. Ndryshimet në jeten e dobishme të parashikuar ose në modelin e parashikuar të konsumimit të përfitimeve ekonomike të ardhshme të aktivitetit llogariten duke ndryshuar metodën ose periudhën e amortizimit, sic është e përshtatshme, dhe trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël.

Fitimi ose humbja që rezultojnë nga c'regjistrimi i aktiveve afatgjata jomateriale llogaritet si diferenca ndërmjet të ardhurave neto nga shitja dhe vlerës kontabël të aktivitetit dhe njihet në të ardhura/shpenzime kur aktiviteti c'regjistrohet.

Jetegjatesia e dobishme e aktiveve afatgjata jomateriale vlerësohet të jete e fundme.

Amortizimi llogaritet në metode lineare përgjate jetes se dobishme ekonomike të vlerësuar të aktiveve afatgjata jomateriale.

Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale me jete të dobishme të përcaktuar është si më poshtë:

<b>Pershkrimi</b>	<b>Norma vjetore e amortizimit</b>
Programe kompjuterike	14% deri 28%

*(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)*

### **3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **(e) Inventari**

Inventari paraqitet me vlerën më të ulët mes kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Shpenzimet duke përfshirë të gjitha shpenzimet e blerjes të lidhura me blerjen, transportin, tarifatat doganore dhe sigurimin e ngarkesave. Inventarët janë duke u vlerësuar në baza mesatare. Vlera neto e realizueshme paraqet çmimin përfundimtar të shitjes për inventarët minus të gjitha kostot e vlerësuara të kompletimit dhe shpenzimet e nevojshme për të bërë shitjen.

#### **(f) Rënia në vlerë**

##### *Aktivitet financiar*

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo date raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar bie në vlerë nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në rënien e vlerës së tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivitetit, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në vlerësimin e flukseve të ardhshme nga aktiviteti të cilat mund të maten me besueshmëri.

Humbja nga rënia në vlerë e aktivitetit të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar të aktualizuara me normën fillestare efektive të interesit. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në humbje ose fitim) në një llogari zbritje kundër të arkëtueshmet. Interesi nga aktivitetet e zhvlerësuara në këtë mënyrë vazhdon të njihet nëpërmjet zbritjes së skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shuma përkatëse rimerret nëpërmjet pasqyrës përmbledhëse të të ardhurave, fitimit ose humbjeve.

##### *Aktivitet jo financiar*

Vlera kontabël e aktiveve jo financiare të Shoqërisë rishikohet në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë për rënie në vlerë. Nëse ekziston ndonjë evidence e tillë atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të vlerësuara skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqeve specifike të aktiveve që nuk janë marrë parasysh në vlerësimin e flukseve të ardhshme.

Humbje nga rënia e vlerës njihet nëse vlera kontabël e aktivitetit ose e njësisë të tij të gjenerimit të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

#### **(g) Përfitimet e punonjësve**

##### *Kontributet e sigurimeve shoqërore*

Gjatë ecures normalë të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacion. Këto kosto të kryera në emër të Shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin e ndodhjes.

#### **(h) Provigjonet**

Provigjoni njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vërtetësi, dhe ka mundësi që të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parasë për të shlyer këtë detyrim. Provigjonet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

*(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)*

### **3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **(i) Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat janë flukset bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat gjenerohen përgjatë ecurisë normale të aktiviteteve të biznesit.

Të ardhurat përbëjnë vlerën e drejtë të mallrave dhe shërbimeve të shitura hequr tatimin mbi vlerën e shtuar dhe skonto. Të ardhurat njihen kur shumat e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme, është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të rrjedhin tek njësi ekonomike, kostoja e shkaktuar ose që do të shkaktohet mund të matet në mënyrë të besueshme dhe kriteret e të ardhurave janë përmbushur. Të ardhurat njihen si më poshtë:

#### ***Shitja mallrave***

Shitjet e mallrave janë të njohura kur Shoqëria i ka transferuar blerësit rreziqet e mëdha dhe përfitimet e pronësisë, përgjithësisht kur konsumatori ka marrë dorëzimin e padiskutueshëm të mallrave. E ardhura e regjistruar është shumata bruto e shitjes, duke përfshirë komisionet e pagesave me kartë krediti të pagueshme për transaksionin. Tarifat e tilla janë të përfshira në kostot e shpërndarjes. Të ardhurat nga shitja e mallrave me asnjë detyrim të rëndësishëm të shërbimit njihet në ofrimin e mallit.

#### ***Kryerja e shërbimeve***

Shitjet e shërbimeve janë të njohura në periudhën kontabël në të cilën shërbimet janë kryer, duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit vlerësuar mbi bazën e shërbimit aktual të parashikuar si një pjesë e shërbimeve të përgjithshme që do të ofrohen.

#### ***Të ardhura nga interesi***

Të ardhurat nga interesi përfitohen në baza kohore, duke iu referuar principalit të papaguar dhe të normës efektive të interesit.

#### **(j) Pagesat e qerasë**

Qeratë klasifikohen si qera financiare kur kushtet e qerasë transferojnë në mënyrë domethënëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë tek qeramarrësi. Të gjitha qeratë e tjera klasifikohen si qera operative. Pagesat e bëra për qeranë operative janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës

#### **(k) Të ardhurat dhe kostot financiare**

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga kursi i këmbimi.

Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare.

Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto.

#### **(l) Kostot e huamarrjes**

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve, deri në momentin kur këto aktive janë gati për qëllimin e tyre për përdorim ose për shitje.

Të ardhurat nga investimet e përkohshme, për sa i përket disa huave të veçanta, të cilave ende nuk ju është paguar interesi, kjo shumë ju zbritet kostove të huamarrjes dhe nuk i kapitalizohet kostos së aktivitetit.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

*(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)*

### **3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **(m) Shpenzime për tatim fitimin**

Tatimi mbi fitimin nënkupton tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zera të njohur direkt në kapital, në të cilat regjistrohen direkt në kapital.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm, i pagueshëm mbi fitimin e tatueshem për vitin, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke paraqitur për diferencat e përkohshme midis vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, bazuar në ligjet që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv i tatimit të shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhurat e ardhshme të tatueshme do të realizohen kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme që përfitimet tatimore të lidhura me të do të realizohen.

#### **(n) Zotimet dhe kontingjentet**

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur vetëm nëse mundësia e një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Aktivit kontingjent nuk është njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme. Shuma e humbjes kontingjente është njohur si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme do të konfirmojnë se, një detyrim i pësuar në datën e bilancit aktual dhe një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes së rezultuar të mund të bëhet.

#### **(o) Transaksionet e palëve të lidhura**

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarët dhe drejtorët e kompanisë, së bashku me subjektet që ata kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë influencë të rëndësishme mbi operacionet dhe menaxhimin e kompanisë. Kur konsiderohet çdo marrëdhënie ndërmjet palëve, vëmendje i kushtohet substancës së marrëdhënies dhe jo thjesht formën ligjore.

#### **(p) Ngjarjet pas datës së bilancit**

Ngjarjet pas përfundimit të vitit të cilat japin informacione shtesë për pozitën e kompanisë në datën e bilancit të gjendjes (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas përfundimit të vitit që nuk janë ngjarje rregulluese janë shpalosur në shënime kur ato janë materiale.

(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

#### 4. Standarde dhe interpretime të publikuara që kanë hyrë në fuqi

Politikat kontabël të adoptuara janë konsistente me ato të vitit financiar të kaluar, përveç SNRF e mëposhtme të reja dhe të amenduara dhe interpretimet e KIFRN të vlefshme nga 1 janar 2015:

*Ndryshimet në SNK 19 - "Kontributet e punonjësve" (publikuar në nëntor 2013 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2014).* Ndryshimi lejon njësitë ekonomike të njohin kontributet e punonjësve si ulje të kostos së shërbimit në periudhën në të cilën është dhënë shërbimi i punonjësit, në vend të shpërndarjes të kontributeve për periudhat e shërbimit, nëse shumat e kontributeve të punonjësve është e pavarur nga numri i viteve të shërbimit.

*Përmirësimet vjetore në SNRF-të 2012 (publikuar në dhjetor 2013 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 korrik 2014, nëse nuk shprehet ndryshe më poshtë).* Përmirësimet përbëhen nga ndryshimet në shtatë standarde. SNRF 2 u ndryshua për të sqaruar përkufizimin e një "kondite kushtëzimi" dhe për të përkufizuar veçmas 'kushtin e performancës' dhe 'kushtin e shërbimit'; Ndryshimi hyn në fuqi për transaksionet e pagesave të bazuara në aksione për të cilat data e grantit është më ose pas 1 korrik 2014.

SNRF 3 është ndryshuar për të sqaruar se (1) një detyrim për të paguar një shumë të kushtëzuar që plotëson përkufizimin e një instrumenti financiar të klasifikuar si një detyrim financiar ose si kapital neto, në bazë të përcaktimeve të SNK 32, dhe (2) të gjithë shumat e kushtëzuara të cilat nuk klasifikohen si kapital neto, të cilat mund të jenë financiare dhe jo-financiare, maten me vlerën e drejtë në çdo datë raportimi, me ndryshimet në vlerën e drejtë të njohura në fitim dhe humbje. Ndryshimet në SNRF 3 janë efektive për kombinimet e biznesit, ku data e blerjes është më ose pas datës 1 korrik 2014.

SNRF 8 u ndryshua për të kërkuar (1) dhënien e informacioneve shpjeguese mbi gjykimet e bëra nga manaxhimi në segmentet operative të agreguara, duke përfshirë një përshkrim të segmenteve të cilat kanë qenë të agreguara dhe treguesve ekonomikë të cilat janë vlerësuar në përcaktimin se segmentet e agreguara ndajnë karakteristika të ngjashme ekonomike, dhe (2) një rakordim të aktiveve të segmentit me aktivet e njësisë ekonomike, kur raportohen aktivet e segmentit.

Baza për përfundimet në SNRF 13 u ndryshua për të sqaruar se fshirja e disa paragrafëve të caktuar në SNK 39 me publikimin e SNRF 13 nuk është bërë me qëllim për të hequr aftësinë për të matur të llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme afatshkurtëra në shumën e faturës ku ndikimi i skontimit është jomaterial.

SNK 16 dhe SNK 38 u ndryshuan për të sqaruar se si trajtohen vlera kontabël bruto dhe amortizimi i akumuluar kur njësitë ekonomike përdor modelin e rivlerësimit. SNK 24 u ndryshua për të përfshirë si një palë të lidhur, një njësi ekonomike që ofron shërbimet e personelit kyç të manaxhimit të njësisë ekonomike raportuese ose mëmës së njësisë ekonomike raportuese (njësia manaxhuese), dhe për të kërkuar të japë informacion mbi shumat e ngarkuara njësisë raportuese nga njësitë manaxhuese për shërbimet e ofruara.

*Përmirësimet vjetore në SNRF-të 2013 (publikuar në dhjetor 2013 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 korrik 2014)* Përmirësimet përbëhen nga ndryshimet në katër standarde.

Baza për përfundimet në SNRF 1 u ndryshua për të sqaruar se, kur një version i ri i një standardi nuk është ende i detyrueshëm, por është i disponueshëm për adaptim të mëparshëm; adaptuesi për herë të parë mund të përdorë versionin e vjetër ose versionin e ri, me kusht që i njëjti standard të zbatohet në të gjitha periudhat e paraqitura.



*(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)*

#### 4. Standarde dhe interpretime të publikuara që kanë hyrë në fuqi (vazhdim)

SNRF 3 u ndryshua për të sqaruar se nuk zbatohet për kontabilitetin për formimin e ndonjë marrëveshje të përbashkët sipas SNRF 11. Ndryshimi gjithashtu sqaron se përjashtimi nga objekti i standardit zbatohet vetëm në pasqyrat financiare të vetë marrëveshjes së përbashkët. Ndryshimi i SNRF 13 sqaron se përjashtimi nga portofolit në SNRF 13, i cili lejon një njësi ekonomike të matsë vlerën e drejtë të një grupi aktivesh financiare dhe detyrimesh financiare mbi një bazë neto, zbatohet për të gjitha kontratat (përfshirë kontratat për të blerë ose shitur zërat jo-financiarë) që janë brenda objektit të SNK 39 ose SNRF 9.

SNK 40 u ndryshua për të sqaruar se SNK 40 dhe SNRF 3 nuk janë reciprokisht përjashtuese. Udhëzimi në SNK 40 ndihmon përgatitësit të bëjnë dallimin midis aktivitetit afatgjatë material të investuar dhe pasurisë së zotëruar nga pronari. Përgatitësit gjithashtu duhet t'i referohen udhëzimeve në SNRF 3 për të përcaktuar nëse blerja e një aktiviteti afatgjatë material të investuar është një kombinim biznesi.

#### 5. Standarte të emetuara por që ende nuk kanë hyrë në fuqi dhe nuk janë adoptuar ende

Një numër standardesh të reja, amendime të standardeve dhe interpretime janë efektive për vitet që fillojnë pas datës 1 janar 2016 (të listuara më poshtë), dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

**SNRF 9 Instrumentet Financiare - Klasifikimi dhe matja** - Standardi aplikohet për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018, por lejohet adoptimi i hershëm. Faza përfundimtare e SNRF 9 pasqyron të gjitha fazat e projektit të instrumenteve financiare dhe zëvendëson SNK 39 *Instrumentet financiare: Njohja dhe Matja* dhe të gjithë versionet e mëparshme të SNRF 9. Standardi prezanton kërkesa të reja për klasifikimin dhe matjen, zhvlerësimin dhe kontabilitetin mbrojtës. Shoqëria është duke vlerësuar ndikimin e këtij ndryshimi dhe nëse ky standard do të aplikohet më herët.

**SNRF 11 Marrëveshjet e përbashkëta (Ndryshimi): Kontabiliteti i Marrjes së Interesave në Operacione të Përbashkëta:** Shoqëria nuk ka asnjë marrëveshje të përbashkët.

**SNRF 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët** - Standardi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2017. SNRF 15 përcakton një model me pesë-hapa që do të aplikohet për të ardhurat e fituara nga një kontratë me klientin (me përjashtime të kufizuara), pavarësisht nga lloji i transaksionit të të ardhurave apo industrisë. Kërkesat e standardit do të aplikohen, gjithashtu për njohjen dhe matjen e fitimeve dhe humbjeve mbi shitjen e disa aktiveve jo-financiare që nuk janë transaksione të veprimtarive të zakonshme të entitetit (p.sh. shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale). Dhënia e gjerë e informacioneve shpjeguese do të jetë e nevojshme, përfshirë ndarjen e të ardhurave totale, informacionin rreth detyrimeve të performancës, ndryshimet në ekuilibrat e logaritjeve të aktiveve dhe detyrimeve të kontratës ndërmjet periudhave, gjykimeve dhe preventivave kryesore. Shoqëria është duke vlerësuar ndikimin që standardi do të ketë, megjithatë nuk pritet të ketë ndikim të rëndësishëm për Shoqërinë.

(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

**5. Standarte të emetuara por që ende nuk kanë hyrë në fuqi dhe nuk janë adoptuar ende (vazhdim)**

BSNK ka publikuar Përmirësimet Vjetore për SNRF-të Cikli 2012 – 2014, që është një përmbledhje e ndryshimeve të SNRF-ve. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2016.

- **SNRF 5 Aktive Afatgjata që mbahen për t'u shitur dhe Operacionet Jo-të Vijueshme:** Ndryshimi sqaron se ndryshimi nga një prej metodave të shitjes tek tjetra (përmes shitjes apo përmes shpërndarjes tek pronarët) nuk duhet të konsiderohet si një plan i ri shitjeje, por si një vazhdim i planit original. Prandaj, nuk ka ndërprerje të zbatimit të kërkesave në SNRF 5. Amendimi, gjithashtu sqaron se ndryshimi i metodës së shitjes nuk ndryshon datën e klasifikimit.
- **SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese:** Ndryshimi sqaron se një kontratë shërbimi që përfshin një tarifë mund të përbëjë përfshirje të vazhdueshme në një aktiv. Gjithashtu, ndryshimi sqaron se SNRF 7 jep informacionet shpjeguese lidhur me kompensimin e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare se janë të nevojshme në pasqyrat financiare të ndërmjetme.
- **SNK 19 Përfitimet e Punonjësve:** Ndryshimi sqaron se thellësia e tregut të obligacioneve me cilësi të lartë të korporatave vlerësohet në bazë të monedhës në të cilën detyrimi është i shprehur, se sa vendi ku detyrimi ndodhet. Kur nuk ka treg të thellë për obligacione me cilësi të lartë të korporatave në atë monedhë, duhet të përdoren normat e obligacioneve qeveritare.
- **SNK 34 Raportimi Financiar i Ndërmjetëm:** Shoqëria nuk raporton pasqyra financiare të ndërmjetme për qëllime të përgjithshme.

**IAS 1: Paraqitja e shënimeve shpjeguese (Ndryshuar)**

Ndryshimet në SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* inkurajojnë kompanitë për të aplikuar gjykimin profesional në përcaktimin e informacionit për t'u paraqitur në pasqyrat financiare si shënime shpjeguese dhe si ta strukturojnë atë në pasqyrat e tyre financiare. Ndryshimet bëhen efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2016. Ndryshimet në SNK-në më së shumti sqarojnë sesa ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme kërkesat ekzistuese të SNK 1. Ndryshimet kanë të bëjnë me materialitetin, rradhën e shënimeve, nëntoatlet dhe ndarjen, politikat kontabël dhe paraqitjen e zërave të të ardhurave të tjera përmbledhëse që rrjedhin nga kontabilizimi i investimeve në kapital. Shoqëria është duke vlerësuar ndikimin e këtij ndryshimi, ndërsa përpiqet të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme paraqitjen dhe rëndësinë e informacionit në pasqyrat financiare.

Shoqëria ka zgjedhur të mos i zbatojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave kur ato bëhen të zbatueshme. Shoqëria parashikon se zbatimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim të rëndësishëm mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë në periudhën e zbatimit fillestar, për shkak të natyrës së kufizuar të transaksioneve që kryen.

**ALMARK SH.P.K.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015***(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***6. Te ardhurat**

Shitjet sipas kategorive per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015 jane analizuar si me poshte:

Të ardhurat nga shitja janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve të ofruara.

Shitjet e Shoqerise te grupuara sipas departamenteve paraqiten si me poshte:

	<b>Periudha nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015</b>
Ushqime te paketuara, detergjente dhe produkte kozmetike	1,559,039
Ushqim i fresket	326,276
<b>Total produkte ushqimore</b>	<b>1,885,315</b>
Produkte joushqimore	116,211
Produkte elektronike dhe elektrike	19,145
Tekstile	28,016
<b>Total produkte jo ushqimore</b>	<b>163,372</b>
<b>Totali</b>	<b>2,048,687</b>

**7. Te ardhura te tjera operative**

	<b>Periudha nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015</b>
Sherbime per furnitoret e produkteve	81,813
Tarifat e hyrjes	6,549
Te ardhura te tjera	7,657
<b>Totali</b>	<b>96,019</b>

Sherbimet e dhena ndaj furnitoreve te mallrave jane te lidhura me aktivite e promovimit te ofruara nga Shoqeria per furnitoret e mallrave/sherbimeve. Promovime te tilla perfshijne marketingun e produkteve ne treg dhe fletepalosje te leshuara nga Shoqeria.

**8. Kosto e mallrave te shitura**

	<b>Periudha nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015</b>
Ushqimore	1,652,196
Jo ushqimore	143,798
<b>Totali</b>	<b>1,795,994</b>

**ALMARK SH.P.K.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015***(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***9. Shpenzime materialesh**

	<b>Periudha nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015</b>
Materiale te konsumueshme per riparime dhe mirembajtje	9,287
Karburant	2,307
<b>Totali</b>	<b>11,594</b>

**10. Shpenzime per sherbime**

	<b>Periudha nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015</b>
Qira operative e pasurive te patundshme	280,653
Shpenzime energjie, ngrohje, uje	91,948
Shpenzime reklama dhe marketing	33,008
Shpenzime sigurie	19,549
Sherbime rekrutimi	18,530
Materiale (qese Plastike)	14,476
Tarifa bankare dhe komisione	8,122
Shpenzime pastrimi	7,452
Tarifa Franchise	4,900
Shpenzime per konsulence kontabel dhe audit	2,879
Shpenzime telekomunikacioni	2,824
Shpenzime noteriale dhe ligjore	285
<b>Totali</b>	<b>484,626</b>

Sherbimet e konsulences nga palet e lidhura jane te lidhura me tarifat e menaxhimit te ngarkuara nga Balfin shpk per mbeshtetjen e menaxhimit dhe sistemet operative te Shoqerise. Tarifa Franchise eshte regjistruar bazuar ne kontraten Franchise te perdorimit te emrit Carrefour. Materialet kane te bejne me ambalazhet me logo

**11. Perfitime te punonjesve**

Shpenzimet e punonjesve per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015 paraqiten si me poshte:

	<b>Periudha nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015</b>
Paga baze dhe pagesa te tjera	107,342
Kontribute te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore	17,144
<b>Totali</b>	<b>124,486</b>

**12. Fitime/(humbje) neto nga kurset e kembimit**

	<b>Periudha nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015</b>
Te ardhura nga konvertimi	8,051
Humbje nga konvertimi	(1,378)
<b>Fitime neto nga kurset e kembimit</b>	<b>6,674</b>

**ALMARK SH.P.K.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015***(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***13. Shpenzime te tjera**

Shpenzime te tjera per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015 paraqiten si me poshte:

	<b>Periudha nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015</b>
Provizion	73,140
Taksa dhe tarifa	4,865
Udhetime biznesi	1,450
Kancelari	1,211
Sigurime te tjera	447
Gjoha dhe penalitete	346
Te tjera	4,944
<b>Totali</b>	<b>86,403</b>

Provizioni prej 73,140 mije Lek lidhet me provizionim e te drejtave ndaj CMB shpk.

**14. Shpenzime financiare neto**

Balancat perbehen si me poshte:

	<b>Periudha nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015</b>
Shpenzime interesi per paradhenie bankare	8,729
Shpenzime interesi per kredi bankare	2,103
<b>Totali</b>	<b>10,832</b>

Shoqeria ka nje linje Overdrafti ne Veneto Bank ne vleren 280 milion lek per te cilen paguan 6.35% interes vjetor dhe nje kredi te marre ne FIB Bank per te cilen interesi eshte 6.1%.

**ALMARK SH.P.K.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015***(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***15. Tatimi mbi fitimin**

Rakordimi midis fitimit kontabel para tatimit dhe shpenzimit të tatimit është si me poshte:

	<b>Periudha nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015</b>
Humbja para tatimit	(376,857)
<i>Shtesat:</i>	
Provizione	73,140
Shpenzimet e pazbritshme për efekt tatimor	1,089
Amortizimi për efekt tatimor	(9,180)
<b>Shpenzimet e pazbritshme për efekt tatimor</b>	<b>65,049</b>
<b>Humbjet para tatimit</b>	<b>(311,808)</b>
Tatimi mbi fitimin me 15%	-
<b>Humbje tatimore e mbartur</b>	<b>(311,808)</b>

Aktivitet tatimore të shtyra që lidhen me humbjet e mbartura dhe diferencat e perkohshme të zbritshme njihen nëse është e mundur që të përdoren (kompensohen) kundrejt fitimit të ardhshëm tatimor ose kundrejt diferencave të perkohshme ekzistuese.

Diferencat e perkohshme të zbritshme kundrejt aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale lidhen me normat e ndryshme të amortizimit të lejueshme për qelime të përlogaritjes së tatimit mbi fitimin.

Humbjet tatimore mund të mbarten deri në 3 vjet. Diferencat e zbritshme të perkohshme nuk skadojnë sipas legjislacionit tatimor aktual.

**ALMARK SH.P.K.**

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015**

*(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)*

**16. Aktivet afatgjata materiale**

Aktivët afatgjata materiale për vitin e mbylltur me 31 dhjetor 2015 paraqiten si me poshte:

2015	Makinëri pajisje instrumentale e vegta pune	Mjete Transporti	Pajisje dhe raffe	Pajisje dhe mobilitë zyre	Aktivët te tjera	Totali
Vlera kontabel bruto në fillim të periudhës	-	-	-	-	-	-
Shtesa	214,105	1,419	4,451	15,002	3,030	238,007
Shitje	-	-	-	-	-	-
Vlera kontabel bruto në fund të periudhës	214,105	1,419	4,451	15,002	3,030	238,007
Amortizimi akumuluar në fillim të periudhës	-	-	-	-	-	-
Amortizimi vitit	11,603	115	907	951	308	13,884
Shitje	-	-	-	-	-	-
Amortizimi akumuluar në fund të periudhës	11,603	115	907	951	308	13,884
Vlera kontabel neto në fillim të periudhës	-	-	-	-	-	-
Vlera kontabel neto në fund të periudhës	202,502	1,304	3,544	14,051	2,722	224,123

**ALMARK SH.P.K.**

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën nga 1 prill 2015 (data e krijimit)  
deir më 31 dhjetor 2015

(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

**17. Aktive afatgjata jomateriale**

Aktivet afatgjata jomateriale per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015 paraqiten si me poshte:

2015	Programe kompjuterike	Totali
Vlera kontabel bruto ne fillim te periudhes	-	-
Shtesa	5,493	5,493
Shitje	-	-
<b>Vlera kontabel bruto ne fund te periudhes</b>	<b>5,493</b>	<b>5,493</b>
Amortizimi akumuluar ne fillim te periudhes	-	-
Amortizimi vitit	415	415
Shitje	-	-
<b>Amortizimi akumuluar ne fund te periudhes</b>	<b>415</b>	<b>415</b>
Vlera kontabel neto ne fillim te periudhes	-	-
<b>Vlera kontabel neto ne fund te periudhes</b>	<b>5,078</b>	<b>5,078</b>

**18. Inventari**

Inventari per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015 paraqitet si me poshte:

	31 dhjetor 2015
Ushqimore	605,288
Jo ushqimore	3,736
<b>Totali</b>	<b>609,024</b>

**19. Llogari te arketueshme dhe te drejta te tjera**

	31 dhjetor 2015
Te arketueshme nga CMB (shenim 19.1)	220,481
TVSH e arketueshme	157,855
Kliente per rabate	45,635
Rabatet e perllogarituara	41,404
Kliente per kupona	19,099
Kliente per shitje malli	14,044
Parapagime	4,659
Garancite e qerave	5,675
Shpenzime te shtyra	4,979
Parapagim dogane	1,715
<b>Totali</b>	<b>515,546</b>

Llogarite e arketueshme dhe te drejtat e tjera jane te rregullta apo te vonuara me pak se 90 dite, pra jo te zhvleresuara.

Drejtimi beson se TVSH-ja e arketueshme eshte plotesisht e rikuperueshme.

**19.1 Detyrimet nga klientët neto**

	31 dhjetor 2015
Detyrime nga CMB, bruto	293,621
Minus zhvleresimi i akumuluar	(73,140)
<b>Detyrimi neto</b>	<b>220,481</b>

Llogarite e arketueshme dhe te drejtat e tjera gjithashtu perfshijne 220 milione leke detyrime te CMB shpk te cilat mbulohen me nje garanci bankare nga Marinopoulos SA.



**ALMARK SH.P.K.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015***(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***20. Mjete monetare dhe ekuivalentet e saj**

	<u>31 dhjetor 2015</u>
Arka	31,309
Mjete monetare ne banke ne lek	68,453
Mjete monetare ne bank ne euro	22,703
<b>Totali</b>	<b><u>122,465</u></b>

**21. Kapitali aksionar**

Almark sh.p.k është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në bazë të legjislacionit shqiptar më 01 prill 2015. Me 31 dhjetor 2015 kapitali i regjistruar dhe plotësisht i paguar është 79,786 mijë LEK dhe përbehet nga një aksion i zakonshëm me vlerë nominale 79,786 mijë LEK

**22. Huate**

	<u>31 dhjetor 2015</u>
<i>Principal</i>	
Kontribut nga Balfin	347,577
Kredi Bankare	205,920
Paradhenie Bankare	283,809
<b>Totali</b>	<b><u>837,307</u></b>
<i>Interesa</i>	
Kredi nga Banka.	2,103
Paradhenie Bankare	8,729
<b>Totali</b>	<b><u>10,832</u></b>
Me vonese	3,809
Afatshkurter (deri në një vit)	320,361
Afatgjate (mbi një vit)	513,136

**Kontribut nga Ortaku Balfin shpk**

Gjate vitit 2015 Ortaku i kompanisë ka kontribuar me mjete monetare për të mbështetur nevojat për pagesa të kompanisë të sapokrijuar. Këto mjete monetare janë bërë në periudha të ndryshme gjatë vitit 2015 dhe nuk mbajnë interes.

**Kredi nga First Investment Bank**

Me 16 shtator 2015, Shoqëria ka nënshkruar një kredi afatmesme (4 vit maturimi) me First Investment Bank, për një shumë totale prej 1,500 mijë EUR (ekuivalenti 205,920 mijë LEK). Huaja do të ketë një normë interesi prej EURIBOR 2M plus 6.2% në vit.

Pagesat e interesit janë të pagueshme në fund të çdo muaji kalendarik duke u bazuar në numrin faktik të ditëve të kaluara dhe duke supozuar një vit me 360 dite. Principali është i pagueshem në kështu të barabartë mujore; kështu që i principalit është i pagueshem 6 muaj pas tërheqjes së pare.

**Overdraft**

Me 27 Maj 2015, Veneto Bank Sh.a. dhe Shoqëria lidhen në marrëveshje për kredi për kapital qarkullues deri në shumën 280,000 mijë Lek, me afat 1 vit që nga tërheqja e pare. Norma e aplikueshme e interesit është EURIBOR 3M plus 3.00% në vit për shumën e përdorur në Lek dhe pagesat e interesit janë të pagueshme në fund të çdo tremujori kalendarik duke u bazuar në numrin faktik të ditëve të kaluara dhe duke supozuar një vit me 360 dite. Pagesa e plote e principalit është e pagueshme në ditën e fundit të afatit të kredise.

**ALMARK SH.P.K.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015***(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***23. Llogari te pagueshme dhe detyrime te tjera**

	<b>31 dhjetor 2015</b>
Llogari te pagueshme neto ndaj furnitoreve te mallrave	676,103
Detyrime ndaj furnitoreve per shpenzime te pergjithshme	244,039
Detyrime te perllogaritura	10,000
Detyrime te pagueshme per sigurime	4,147
Detyrime per tatim ne burim	1,160
Detyrime per tatim page	551
<b>Totali</b>	<b>936,000</b>

Te gjitha detyrimet shlyhen normalisht brenda 180 diteve te para pas periudhes raportuese. Detyrimet ndaj furnitoreve te mallrave shlyhen ne baze te faturimit. Pjesa me e madhe e llogarive te pagueshme i detyrohet Tirana East Gate, Neptun, pale e lidhur (shenimi 24) dhe furnitoreve te mallrave si Alfa sha Albania Distribution Development etj.

**24. Palet e lidhura**

Shoqeria ka marredhenie ndermjet ndermarrjeve, per shkak te transaksioneve me Shoqerine Meme dhe shoqerite simotra te saj. Palet e lidhura te Shoqerise dhe marredhenia e tyre me 31 dhjetor 2015 paraqitet si me poshte:

<b>31 dhjetor 2015</b>	<b>Shitje Paleve te Lidhura</b>	<b>Blerje Paleve te Lidhura</b>	<b>Llogari te arketueshme</b>	<b>Detyrime</b>
Tirana East Gate TEG	3,467	142,723	3,553	82,682
Milsped Albania sh.p.k	-	120,178	-	32,828
Neptun sh.p.k	642	55,558	1,197	52,723
Qendra Tregtare Univers	223	52,960	223	31,910
Acrem sh.p.k	360	36,005	614	32,851
Kid Zone sh.p.k	77	19,412	252	762
Mane TCI	512	13,800	512	11,284
MZ Fashion	148	5,733	310	5,733
Balfin sh.p.k	570	3,000	2,252	3,000
Plus Communication sh.a	-	2,289	-	206
Food Way	1,969	71	1,959	71
Bookstore sh.p.k	-	10	-	10
Elektro Service	32	-	222	-
Veranda sh.p.k	3,378	-	624	-
Albchrome sh.p.k	2,412	-	1,939	-
Tirana Business University	169	-	105	-
<b>Totali</b>	<b>13,960</b>	<b>451,740</b>	<b>13,761</b>	<b>254,060</b>

**ALMARK SH.P.K.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015***(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***25. Angazhime dhe detyrime të kushtezuara*****Angazhime per qirane operative***

Pagesat minimale të ardhshme të qirase sipas kontratave të qirase operative janë si më poshte:

	<b>31 dhjetor 2015</b>
Jo më vonë se një vit	355,151
Nga 1 vit deri në 5 vjet	1,228,667
Më vonë se 5 vjet	36,242
<b>Totali</b>	<b>1,620,059</b>

Shoqëria ka hyre në angazhime qiraje për të gjitha supermarketet me një kohezgjatje maksimale prej pesë vjetësh.

***Detyrime të mundshme tatimore***

Legjislacioni tatimor dhe doganor shqiptar i cili ishte në fuqi apo që konsiderohet si i tillë në fund të periudhës raportuese është subjekt i interpretimeve të ndryshme kur aplikohet në transaksionet dhe aktivitetet e Shoqërisë. Rrjedhimisht, pozicioni tatimor mund të kundërshtohet nga autoritetet përkatëse. Periudhat fiskale mbeten të hapura për shqyrtim nga organet tatimore shqiptare për pesë vite kalendarike nga viti i shqyrtimit. Në rrethana të caktuara kontrollet mund të mbulojnë periudha më të gjata.

Duke qenë se legjislacioni tatimor shqiptar nuk mund të japë udhëzime definitive në fusha të caktuara, herë pas here, Shoqëria adopton interpretime mbi këto fusha. Nderkohe që drejtimi vlerëson se pozicioni tatimor dhe interpretimet që Shoqëria ka kryer janë të qëndrueshme, ekziston rreziku që të jete e nevojshme përdorimi i burimeve në rast se këto pozicione tatimore dhe interpretime vihen në diskutim nga autoritetet përkatëse.

Ndikimi i këtyre mundësive nuk mund të vlerësohet me besueshmeri, megjithatë, ajo mund të jete e rëndësishme për pozicionin financiar dhe/ose veprimtarinë e përgjithshme të Shoqërisë.

***Proces gjyqësor***

Herë pas here, gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë, ndaj Shoqërisë mund të ngrihen pretendime ligjore. Duke u bazuar në vlerësimet e veta dhe keshillimin profesional të ekspertëve të jashtëm, drejtimi i Shoqërisë është i mendimit se Shoqëria nuk do të peshojë humbje materiale nga këto pretendime me shumë se sa është parashikuar në këto pasqyra financiare. Objektivat dhe politikat e menaxhimit të riskut financiar

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme në lidhje me instrumentet e veta financiare. Rreziqet kryesore të mundshme janë rreziku i tregut, rreziku i kredise dhe rreziku i likuiditetit.

*(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***26. Objektivat dhe politikat e menaxhimit të riskut financiar**

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme në lidhje me instrumentet e veta financiare. Rreziqet kryesore të mundshme janë rreziku i tregut, rreziku i kredise dhe rreziku i likuiditetit.

**26.1 Rreziku i tregut**

Rreziku i tregut është rreziku që vlera e drejte e flukseve të ardhshme monetare nga instrumentet financiare do të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në cmimet e tregut. Cmimet e tregut përfshijnë tre lloje rreziqesh: rreziku i normes së interesit, rreziku i kursit të këmbimit dhe rreziku i cmimeve të tjera, si për shembull rreziku i ndryshimit të cmimeve të letrave me vlerë të tregtuara në bursë. Instrumentet financiare të ndikuara nga rreziku i tregut përfshijnë kredite dhe llogarite e pagueshme.

Analizat e ndjeshmerisë në seksionet e mëposhtme lidhen me pozicionin më 31 dhjetor 2015. Analizat e ndjeshmerisë janë përgatitur sipas supozimit se shumica e borxhit dhe pjesa e instrumenteve financiare në monedhe të huaja janë konstante. Analiza përshkruan ndikimin e ndryshimeve të variablave të tregut të provigjoneve.

***Rreziku i normes së interesit***

Rreziku i normes së interesit është rreziku se vlera e drejte e flukseve të ardhshme monetare nga instrumentet financiare do të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në normën e interesit të tregut. Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të ndryshimit të normave të interesit të tregut lidhet fillimisht me detyrimet afatshkurtra të Shoqërisë me norma të interesit të ndryshueshme. Duke qenë se këto kredi janë kryesisht afatshkurtra, Shoqëria nuk e konsideron rrezikun të rëndësishëm dhe nuk ka adoptuar ende ndonjë politikë për ta zvogeluar atë. Tabela e mëposhtme tregon ndjeshmerinë ndaj ndryshimeve të mundshme dhe të arsyeshme të normes së interesit, me të gjitha variablat e tjera të mbajtura konstante, në fitimin e Shoqërisë para tatimit (përmes ndikimit të normave të ndryshueshme të kredise).

	Ndryshime në normën e interesit (%)	Efektet në rezultat përpara tatimit (mijë LEK)
<b>2015</b>		
Kredi me interes	+1%	4,903
(490,257 mijë LEK)	-1%	(4,903)

***Rreziku i kursit të këmbimit***

Rreziku i kursit të këmbimit është rreziku që vlera e drejte e flukseve të ardhshme monetare nga instrumentet financiare do të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit. Shoqëria hyn në transaksione me valute të huaja lidhur me aktivitetin e saj financiar dhe operativ. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument financiar specifik për t'u mbrojtur nga rreziku. Pjesa më e madhe e transaksioneve të Shoqërisë janë në EUR dhe LEK dhe meqenëse kursi i këmbimit Lek/Euro është i qëndrueshëm, rreziku i kursit të këmbimit konsiderohet të jetë i ulët.

31 dhjetor 2015	EUR	LEK	Totali
<b>Aktive financiare</b>			
Mjete monetare	22,731	99,734	122,465
Llogari të arketueshme	-	515,546	515,546
	<b>22,731</b>	<b>615,280</b>	<b>638,011</b>
<b>Detyrime financiare</b>			
Furnitore dhe detyrime të tjera	-	935,000	935,000
Hua	298,546	538,761	837,307
	<b>298,546</b>	<b>1,473,761</b>	<b>1,772,307</b>
<b>Hendeku i monedhes 31 dhjetor 2015</b>	<b>(275,814)</b>	<b>(858,481)</b>	<b>(1,134,295)</b>

**ALMARK SH.P.K.**

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën nga 1 prill 2015 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2015**

*(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)*

**26. Objektivat dhe politikat e menaxhimit të riskut financiar (vazhdim)****26.1 Rreziku i tregut (vazhdim)*****Rreziku i kursit të kembimit (vazhdim)***

Gjate vitit janë përdorur kurset e mëposhtme të kembimit:

	<b>Kursi mesatar</b>	<b>Kursi në datën e raportimit</b>
Lek/EUR	139.75	137.28

**26.2 Rreziku i kreditimit**

Rreziku i kreditimit lind në rastin kur arrin të përmbushë detyrimet në rastin e një instrumenti financiar. Shoqëria nuk është e ekspozuar kundrejt një rreziku të rëndësishëm të kreditit duke qenë se ka relativisht nivel të ulët të llogarive të arketueshme nga klientët. Për shkak të karakteristikave të biznesit të saj, Shoqëria shet mallra të një numri të madh konsumatorësh ku çmimi i shitjes paguhet në shumicën e rasteve me para në dorë ose me kartë debiti/krediti. Transaksionet monetare kryhen nepermjet institucioneve që kanë vlerësim të mirë kreditor.

**26.3 Rreziku i likuiditetit**

Menaxhimi efektiv i likuiditetit të Shoqërisë lidhet me sigurimin e financimit të kapitalit qarkullues përmes përdorimit të kredive me interes nga palet e lidhura dhe bankat. Drejtuesit e Shoqërisë vazhdimisht monitorojnë afatin dhe kryerjen e pagesave në kohë duke mbajtur të përditësuar informacionin mbi flukset e nevojshme të parase dhe pagesat e ardhshme. Parate e disponueshme investohen në depozita afatshkurtra me norma interesi më të mira në bankat vendase.

Me 31 dhjetor, struktura e maturitetit të detyrimeve financiare të Shoqërisë ndaj pagesave kontraktuale të paskontuara paraqitet si më poshtë:

	<b>Me vonese</b>	<b>&lt; 3 muaj</b>	<b>3 - 12 muaj</b>	<b>1 - 5 vjet</b>	<b>Totali</b>
<b>31 dhjetor 2015</b>					
Huate me interes	3,809	-	320,362	165,558	489,729
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	-	-	936,000	-	936,000
<b>Totali</b>	<b>3,809</b>	<b>-</b>	<b>1,256,362</b>	<b>165,558</b>	<b>1,425,729</b>

**27. Ngjarje pas dates së raportimit**

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas dates së raportimit që do të kërkonte rregullime ose shënime të tjera shpjeguese në keto pasqyra financiare.